

VENDIM
Nr.658, datë 11.6.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS POSHNJË, TË QARKUT TË BERATIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen, në pronësi ose në përdorim të komunës Poshnjë të qarkut të Beratit, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Poshnjë të qarkut të Beratit, miratuar me vendimin nr.303, datë 24.5.2006 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Poshnjë të qarkut të Beratit”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Poshnjë për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha
Lidhja nr.1

Komuna Poshnjë

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
86-96	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
83-85	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
27-36	Varrezat publike	Në pronësi
117-128	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike).	Në pronësi
38,41,47-57,61-63,66-75,81,82	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
9-17,39,46	Prona që përdoren në fushën e strehimit dhe mbrojtjes civile.	Në pronësi
40,58,59	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
450-490	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
491-504	Prona që përdoren për ushtrimin e	Në pronësi

	funksiioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	
--	---	--